



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 20.01.2021

RAPORT
(Për dhënie mendimi)

PËR
AKTIN NORMATIV
“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.88/2019, “PËR BUXHETIN E
VITIT 2020”, TË NDRYSHUAR”

Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 20.01.2021, mori në shqyrtim Aktin Normativ nr. 34, datë 16.12.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020” të ndryshuar”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Bashkim Fino.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm dhe përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për Financat dhe Ekonominë, Znj. Moza Dhembli, Drejtoresh e Përgjithshme e Buxhetit.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Akti normativ i propozuar për miratim, është akt normativ me fuqinë e ligjit, në bazë të nenit 101 të Kushtetutës, i cili përcakton se Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Referuar alokimeve më të rëndësishme, akti normativ që propozohet, përcakton:

1. Shpenzime korente:

- ✓ Alokimin e fondit 3.4 miliardë lekë për financimin e shpërblimit të fundvitit për kategorinë e pensionistëve, përkatësisht në masën 5 000 (pesë mijë) lekë për çdo pensionist. Ky shpërblim do të përballohet:
 - Në masën 1.7 miliardë lekë nga rritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore;
 - Në masën 1.7 miliardë lekë nga fondet e vetë ISSH, të buxhetuara për vitin 2020.
- ✓ Shtesën e fondeve në masën 1.4 miliardë lekë, për financimin e disa nevojave shtesë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kryesisht për skemën e ndihmës ekonomike & paaftësisë, si rrjedhojë e specifikave të përdorimit të saj gjatë vitit 2020, të karakterizuar nga pasojat sociale të pandemisë COVID-19. Konkretisht:
 - Pagesa e PAK, rreth 816 milionë lekë;
 - Pagesa e NE, rreth 184 milionë lekë.
- ✓ Shtesën e fondeve në masën 420 milionë lekë në zërin e subvencionit të ndërmarrjeve ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., me qëllim, përkatësisht, për:
 - shlyerjen në masën 100% të stokut të detyrimeve të prapambetura në zërin kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, përmes akordimit të fondit 300 milionë lekë për këtë qëllim;
 - shlyerjen në masën 20% të stokut të detyrimeve të prapambetura në zërin tatimfitimi, përmes akordimit të fondit 120 milionë lekë për këtë qëllim.

Akordimi i këtij fondi prej 420 milionë lekë në zërin subvencione ka një efekt neutral në buxhetin e vitit 2020, pasi ai do të shkojë automatikisht për pagesën e detyrimeve të sipërcituara, duke u regjistruar si hyrje (të ardhura) në buxhetin 2020.

- ✓ Shtesën e fondeve për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë në masën:
 - 200 milionë lekë, për financimin e perpunimit të mbetjeve urbane;
 - 9.4 milionë lekë, kundërvlefë e 75 000 eurove, për pagesën e studios së konsulentëve ligjorë në procesin e arbitrazhit ndërkombëtar për ç çështjen TIA.

2. Shpenzime kapitale:

- ✓ Financimin shtesë prej 2.9 miliardë lekësh për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në shkallë vendi, për përmirësimin e furnizimit me ujë të popullsisë.
- ✓ Financimin prej 982 milionë lekësh për projektet e perpunimit të mbetjeve urbane.
- ✓ Financim shtesë në masën 673 milionë lekë për dy projekte prioritare të KQZ-së, përkatësisht “Projektin e identifikimit elektronik të zgjedhësve” dhe “Projektin pilot të votimit dhe numërimit elektronik”.
- ✓ Alokimin e fondit në masën 200 milionë lekësh për shpenzime shpronësimi dhe shlyerje detyrimesh të prapambetura në sektorin e infrastrukturës.
- ✓ Alokimin e fondit shtesë prej 100 milionë lekësh, në programin e kërkimit shkencor, për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
- ✓ Akordimin e një fondi prej 97 milionë lekësh për ngritjen e sistemeve mbështetëse për funksionimin e godinës së SPAK-ut dhe BKH-së.

3. Sa i përket financave vendore:

Ashtu si e gjithë ekonomia në tërësi edhe njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit buxhetor 2020 janë përballur me problematika në mbledhjen e të ardhurave vendore si pasojë e pandemisë COVID-19. Në këto kushte, në raport me planin e miratuar të buxhetit vjetor është vlerësuar e domosdoshme shtesa prej 70 milionë lekësh për disa nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë paraqitur problematikat e vështirësisë financiare në likuidimin e shpenzimeve. Kjo vlerë iu shtohet njësitë të vetëqeverisjes vendore në formën e transfertës së pakushtezuar për vitin 2020. Gjithashtu, në shpenzimet e pushtetit vendor janë bërë ndryshimet si më poshtë:

- ✓ Shtesa prej 200 milionë lekësh në planin e taksave të ndara, me qëllim mbulimin e plotë të fondit që u takon njësitë të vetëqeverisjes vendore në formën e taksës së ndarë nga tatimi mbi të ardhurat personale në zbatim të shkronjës ç, pika 2, e nenit 25, të ligjit nr.68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- ✓ Gjithashtu, një ndryshim do të reflektohet në financimin e huaj të pushtetit vendor ku, si pasojë e përfundimit të një pjese të rëndësishme të projekteve me këtë financim, realizimi është vetëm 200 milionë lekë krahasuar me planin prej 1 miliard lekësh të miratuar. Si rrejdhim, më qëllim rritjen e efijencës së përdorimit të parave publikë vlerësojmë shkurtimin në masën 470 milionë lekë të shpenzimeve për financimin e huaj.

Në përfundim, është me rëndësi të theksohet se ky akt normativ nuk prek parametrat kyç makro-fiskalë, siç janë deficitit buxhetor dhe borxhi publik, të cilët mbeten të pandryshuar.

III. VLERËSIMI I KUSHTETUTESHMËRISË SË AKTIT NORMATIV

Neni 101 i Kushtetutës ka parashikuar të drejtën e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullatore me fuqinë e ligjit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj **me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës** si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra. Akti normativ me fuqinë e ligjit është një instrument që ka për qëllim përshpejtimin e procedurave për nxjerrjen e ligjit, në mungesë të kohës së nevojshme për të filluar një procedurë normale të miratimit të një propozimi për të ndryshuar ligjin.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bazuar në vlerësimet më të fundit të situatës makrofiskale, ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të buxhetit 2020. Ky rishikim propozohet t’i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, aspekti i nevojës dhe emergjencës të së cilit lidhet kryesisht me:

- financimin e shpërblimit të fundvitit për kategorinë e pensionistëve, në masën 3.4 miliardë lekë;
- shtesën e fondeve për financimin e skemës së ndihmës ekonomike & paaftësisë, në masën 1 miliardë lekë.

Gjykata Kushtetuese, në rastet e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së akteve normative, ka konsideruar se e drejta e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit, sipas parashikimeve të nenit 101 të Kushtetutës, përbën një përjashtim nga parimi kushtetues i njohjes dhe përqendrimit të pushtetit ligjvënës në duart e Kuvendit të Shqipërisë, duke lejuar nxjerrjen e akteve me fuqinë e ligjit edhe nga organe të tjera kushtetuese. Sic u theksua edhe mw sipwr, kjo e drejtë ka natyrë **lejuese dhe përjashtimore**, prandaj Kushtetuta, nëpërmjet nenit 101 të saj, i ka njohur të drejtën Këshillit të Ministrave të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit vetëm kur rasti shfaqet **si i jashtëzakonshëm dhe nevoja e urgjenca** bëjnë të pamundur ushtrimin e kompetencës ligjvënëse nga Kuvendi (sipas *vendimit nr.24, datë 10.11.2006*, të Gjykatës Kushtetuese).

Nevoja dhe urgjenca janë elemente përcaktuese të kushtetueshmërisë së aktit normativ. Sipas jurisprudencës kushtetuese, nevoja dhe urgjenca janë rrethana dhe situata fakti që vlerësohen, rast pas rasti. Akti Normativ që po shqyrtojmë vlerësohet se është një akt që del pikërisht në kushtet e nevojës dhe të urgjencës **dhe i plotëson të gjitha kriteret** e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24 datë 10.11.2006, vendimi nr.23 datë 16.4.2014, etj.

V.ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision nga relatori u vlerësua ndërmarrja e kësaj nisme ligjore, për të avancuar më tej në zhvillimin social-ekonomik të vendit si edhe u theksua se ky akt normativ nuk prek parametrat kyç makro-fiskalë, siç janë deficitit buxhetor dhe borxhi publik, të cilët mbeten të pandryshuar.

Gjatë diskutimit, Komisioni mbështeti qendrimin e relatorit dhe e vlerësoi projektligjin shumë të rëndësishëm.

VI. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, votoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me shumicën e votave, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

RELATOR

KRYETARI

BASHKIM FINO

ULSI MANJA